



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I KOMUNITETIT DHE MBËSHTETËS

Nr. ____ Prot.

Maliq më 06.09.2017

Procesverbal

I mbajtur në takimin e Projekt-Buxhetit, ku morën pjesë banorët e Njesisë Administrative Pirg

Në kuadër të ligjit **nr. 146/2014, neni 18** “Pjesëmarrja në takime Publike”, u mbajt sot, **më dt.06.09.2017, ora 14:00** në sallën e mbledhjeve të Njesisë Administrative Pirg , takimi konsultativ (*dëgjesa publike*) mbi programin buxhetor afatmesëm 2018-2020, si dhe për buxhetin vjetor, pjesë e buxhetit afatmesëm.

Në takim morën pjesë : Kryetari i Bashkisë Maliq: z.Gëzim Topçiu , drejtues dhe specialistë të Bashkisë Maliq, banorë të Njesisë Administrative Pirg ,kryetarë të Fshatrave ,përfaqësues të bizneseve, shoqatave ,si dhe grupe e tjera të interesit.

Në vijim të procesit të hartimit dhe përgatitjes së Projekt-Buxhetit afatmesëm për periudhën **2018-2020**, dhe për buxhetin vjetor 2018, takuam dhe dëgjua banorët e Njesisë Administrative Pirg ,për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve që do të realizohen nga Bashkia Maliq, me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat, ku këta banorë jetojnë. Gjatë diskutimit, në thelb të dëgjesave publike ishin, jo vetëm punët dhe investimet e kryera nga Bashkia Maliq gjatë këtyre dy viteve, por dhe kërkesave e nevojave thelbësore në lidhje me përmirësimin e një sërë shërbimesh si ç’janë:

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe ndriçimi publik,sistemimi i kanaleve ujitës dhe kullues në parcelat bujqësore,sistemimi i rrugëve hyrëse në fshatra dhe rrugëve dytësore për në parcelat bujqësore.Theksi u v’u dhe tek përmirësimi i disa objekteve ,si kopshte ,shkolla ,furnizimi me dru zjarri etj.

Takimi u hap me fjalën e Kryetarit të Bashkisë Maliq, e cila u pasua me prezantimin e Projekt-Buxhetit për periudhën **2018-2020**, u bë një analizë e investimeve dhe punëve që janë kryer nga Bashkia Maliq gjatë kësaj periudhe, si dhe u propozua hedhja e ideve dhe mendimeve të banorëve të komunitetit për të përcaktuar prioritetet e investimeve dhe alokimin e fondeve sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit.

Pas prezantimit u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilëve i’u përgjigjën drejtues dhe specialist të Bashkisë që mbulojnë sektorët përkatës.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Stiljan Belishta